


TRI PARIMET

ARGUMENTET E TYRE



MUHAMMED IBN ABDULVEHABI

Tre parimet dhe argumentet e tyre

Nga: shejhul Islam
Muhamed ibën AbdulUehab



-Allahu e mëshiroftë-

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Dije –Allahu të mëshiroftë – se është obligim për ne që të mësojmë katër çështje:

E para: dituria; që është njohja e Allahut, njohja e Pejgamberit të Tij dhe fesë Islame me argumenta.

E dyta: të vepruarit me të.

E treta: thirrja drejt saj.

E katërta: durimi i lëndimeve, për shkak të këtyre çështjeve.

Argument për këtë, është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَالْعَصْرِ (1) إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2) إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ
وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ (3)

“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën (besimin dhe veprat e mira) dhe e këshillojnë njëri-tjetrin me durimin.” [el Asr: 1-3].

Ka thënë Shafiu (Allahu e mëshiroftë): “Sikur Allahu të mos kishte zbritur argument tjetër për krijesat përveç kësaj sureje, atëherë kjo do t’i mjaftonte.”

Ka thënë Buhariu (Allahu e mëshiroftë): “Tema: dituria është (apo vjen) përpara fjalës dhe veprës; dhe argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ

“Dije se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd.” [Muhamed: 19]. Pra, Allahu ka filluar me diturinë përpara fjalës dhe veprës.”

Dije –Allahu të mëshiroftë – se është obligim për çdo musliman dhe muslimane, që të mësojë këto tre çështje, dhe të veprojë me to:

E para: vërtetë Allahu na ka krijuar, na ka furnizuar, dhe nuk është shkujdesur ndaj nesh, përkundrazi, Ai ka dërguar tek ne të Dërguar; kush i bindet (të Dërguarit) futet në Xhenet, ndërsa kush e kundërshton hyn në Zjarr. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَاهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ رَسُولًا (15) فَعَصَىٰ فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ فَأَخَذْنَاهُ أَخْذًا وَبِيلاً

“Vërtet! Ne ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar Faraonit, por Faraoni e kundërshtoi dhe e mohoi të Dërguarin, andaj e dënuam me dënim të rëndë.” [el Muzemil: 15-16].

E dyta: se Allahu nuk është i kënaqur që t’i bëhet Atij shirk (ortak apo i barabartë) dikush në adhurimin e Tij; as një melek i afërt, dhe as një Pejgamber i dërguar. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

“Vërtetë xhamiat (dhe gjymtyrët e trupit) janë për Allahun, andaj mos adhuroni në to (dhe me këto gjymtyrë) askënd bashkë me Allahun.” [el Xhin: 18].

E treta: ai që i bindet Pejgamberit dhe e veçon Allahun (në adhurim), nuk i lejohet atij që të marrë për miq (apo të ndihmojë) persona që kundërshtojnë (me armiqësi) Allahun dhe Pejgamberin e Tij, edhe po të jenë prej njerëzve më të afërm. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٍ مِّنْهُ وَيُدْخِلُهُمْ

جَنَاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ أُولَئِكَ حِزْبُ اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë (me armiqësi) Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka ngulitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vetë. Ai do t’i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut, dhe vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.” [el Muxhadeleh: 22].

Dije – Allahu të drejtoftë drejt bindjes së Tij – se *el Hanifijeh* feja e Ibrahimit, është: ta adhurosh Allahun e Vetëm me sinqeritet dhe duke ja drejtuar te gjitha adhurimet vetëm Atij; me këtë gjë Allahu ka urdhëruar të gjithë njerëzit, dhe për këtë gjë Allahu i ka krijuar (krijesat). Thotë i Lartësuari:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë Mua.” [edh-Dharijat: 56]. **“Më adhurojnë Mua”**, dmth të më veçojnë me adhurim Mua.

Çështja më madhështore për të cilën ka urdhëruar Allahu, është teuhidi, dhe teuhidi është: veçimi i Allahut me adhurim.

Çështja më madhështore të cilën e ka ndaluar Allahu, është shirku, dhe shirku është: adhurimi i dikujt tjetër përveç Allahut, ose bashkë me Të. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا

“Veçojeni Allahun me adhurim dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).” [en-Nisa: 36].

Nëse ty të thuhet: cilat janë ato tre parime që njeriu e ka obligim t’i dijë?

Atëherë thuaj: të njohi Zotin e tij, fenë dhe Pejgamberin e Tij Muhamed *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

↑ Parimi i parë ↑

E nëse të thuhet: kush është Zoti yt?

Atëherë thuaj: Zoti im është Allahu i Cili është kujdesur për mua dhe për gjithë krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i Adhuruari im, dhe nuk ka tjetër të adhuruar për mua përveç Tij. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Të gjitha falenderimet i takojnë Allahut, Zotit të Krijesave.” [el Fatiha:2]. Të gjithë (dhe çdo gjë) përveç Allahut janë krijesa, dhe unë jam një prej krijesave.

E nëse të thuhet: si e njohë Zotin tënd?

Atëherë thuaj: e njoha përmes argumentave dhe krijesave të Tij, dhe prej argumentave të Tij janë: nata, dita, Dielli dhe Hëna. Ndërsa prej krijesave të Tij janë: shtatë qiejt, shtatë tokat, çfarë ka brenda tyre dhe në mes të tyre. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ

“Dhe prej argumentave të Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos bëni sexhde as për Diellin, as për Hënën, por bëni sexhde (dhe adhuroni) vetëm Allahun, i Cili i ka krijuar ato; nëse vërtetë i jeni nështruar Allahut dhe jeni adhurues të Tij!” [Fussilet: 37]. Po ashtu argument është dhe fjala e të Lartësuarit:

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ يُعْشِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

“Vërtet! Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u lartësua mbi Arsh. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij. Vetëm Atij i përket krijimi dhe urdhëresat fetare. Madhëruar qoftë Allahu, Zoti i krijesave!” [el Earaf: 54].

Zoti është: i Adhuruari me të drejtë, dhe argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

يَأْتِيهَا النَّاسُ عِبْدُوا رَبَّكُمْ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ (21) الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O njerëz! Veçojeni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të zbatoni urdhëresat dhe të largoheni nga ndalesat; (veçojehi Zotin tuaj) i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; (veçojehi Zotin tuaj) i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos bëni krijesa të njëjta apo të barabarta me Allahun duke i adhurar ata, duke qenë se ju e dini se nuk ka të njëjtë me Të në krijim.” [el Bekare: 21-22]. Ka thënë Ibën Kethiri: “Krijuesi i këtyre gjërave, ka të drejtë dhe meriton të adhurohet.”

Llojet e adhurimit që Allahu ka urdhëruar, janë: Islami, Imani dhe Ihsani. Gjithashtu prej tyre janë: duaaja (lutja), frika, shpresa, *tevek-kul-i* (të mbështeturit tek Allahu), *er-ragheb* (dëshira për të arritur diçka të dashur), droja, nënshtrimi, *el khashjeh* (frika e ndërtuar mbi dituri), *el inabeh* (rikthimi tek Allahu me pendim), kërkimi i ndihmës, kërkimi i strehimit, kërkimi i shpëtimit, kurhani, zotimi dhe të tjera lloje të adhurimit, që Allahu ka urdhëruar, dhe të cilat i duhen kushtuar vetëm Allahut. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

“Vërtetë xhamiat (dhe gjymtyrët e trupit) janë për Allahun, andaj mos adhuroni në to (dhe me këto gjymtyrë) askënd bashkë me Allahun.” [el Xhin: 18].

Kush ia kushton njëren prej këtyre adhurimeve dikujt tjetër veç Allahut, atëherë ai është mushrik i pafe, dhe argument është thënia e të Lartësuarit:

وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ

“Ai që pos Allahut, i lutet një të adhuruari tjetër, duke mos pasur kurrfarë argumenti për këtë, me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mosbesimtarët.” [el Mu’minun: 117].

Në hadith thuhet:

الدعاء معُ العبادة

“Duaja është thelbi i adhurimit.” Dhe argument është thënia e të Lartësuarit:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

“Zoti juaj ka thënë: dhe më adhuroni (lutmuni) Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj nga adhurimi Im, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!” [Ghafir:60].

Argument për frikën është thënia e Tij:

فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

“Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!” [Aal Imran: 175].

Argument për shpresën është thënia e Tij:

فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا

“Kush shpreson takimin (dhe shikimin) me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd dhe asgjë në adhurim Zotit të vet!” [el Kehf: 110].

Argument për *tevek-kul*-in (të mbështeturit tek Allahu) është thënia e Tij:

وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

“Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni vetëm tek Allahu!” [el Maideh: 23].

وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ

“E kush mbështetet tek Allahu, Allahu i mjafton atij.” [et-Talak: 3].

Argument për *er-raghbeh* (dëshirën për të arritur diçka të dashur), drojën dhe nënshtrimin është thënia e Tij:

إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ

“Me të vërtetë, ata (Pejgamberët) nxitonin për vepra të mira dhe Na adhuronin, me dëshirë (për të arritur atë që gjendet tek Allahu) dhe drojë (nga ndëshkimi), dhe ishin të nënshtruar ndaj Nesh.” [el Enbija’: 90].

Argument për *el khashjeh* (frika e ndërtuar mbi dituri) është thënia e Tij:

فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِي

“Mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje.” [el Bekare: 150].

Argument për *el inabeh* (rikthimi tek Allahu me pendim) është thënia e Tij:

وَأَنِيبُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلَمُوا لَهُ

“Kthehuni të penduar tek Zoti juaj dhe nënshtrohuni Atij.” [ez-Zumer: 54].

Argument për kërkimin e ndihmës është thënia e Tij:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” [el Fatiha: 5]. Ndërsa në hadith thuhet:

إذا استعنت فاستعن بالله

“Nëse kërkon ndihmë, atëherë kërkije prej Allahut.”

Argument për kërkimin e strehimit është thënia e Tij:

قل أعوذ برب الفلق

“Thuaj: kërkij strehim (dhe mbrojtje) tek Zoti i agimit!” [el Felek: 1].

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ

“Thuaj: kërkij strehim (dhe mbrojtje) tek Zoti i njerëzve!” [en-Nas: 1].

Argument për kërkimin e shpëtimit në vështirësi është thënia e Tij:

إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ

“Përkujto kur ju kërkuat shpëtim tek Zoti juaj, dhe Ai ju përgjigj juve.” [el Enfal: 9].

Argument për kurbanin është thënia e Tij:

قل إني هداي ربي إلى صراط مستقيم دينا قيما ملة إبراهيم حنيفا وما كان من المشركين
(161) قل إن صلاتي ونسكي ومحياي ومماتي لله رب العالمين(162) لا شريك له

“Thuaj: vërtetë namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të krijesave. Ai nuk ka asnjë ortak (apo të barabartë në adhurim).” [el En’am: 161-163]. Ndërsa në hadith thuhet:

لعن الله من ذبح لغير الله

“Allahu e mallkoftë atë person që bën kurban për dikë tjetër përveç Allahut!”

Argument për zotimin është thënia e Tij:

يُوفُونَ بِالنَّذْرِ وَيَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا

“Ata e çojnë zotimin në vend dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), sherri i së cilës përhapet gjithkund.” [el Insan: 7].

🕌 Parimi i dytë 🕌

Njohja e fesë Islame me argumenta, Islami është: nënshtrimi ndaj Allahut duke e veçuar Atë me adhurim, nënshtrimi ndaj Tij duke zbatuar urdhëresat dhe duke u larguar nga ndalesat, distancimi nga shirku dhe pasuesit e tij. Islami ka tre gradë: Islami, Imani dhe Ihsani. Secila nga këto tre gradë përbëhet nga shtyllat e saj. Shtyllat e Islamit janë pesë: Shehadeti (dëshmia) se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit, dhe haxhi (vizita e Qabes).

Argumenti i Shehadetit është thënia e të Lartësuarit:

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

“Allahu dëshmon, dhe po ashtu melaiket dhe njerëzit e dijes, se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, i Cili është i drejtë në të gjitha çështjet dhe veprat e Tij; nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, dhe Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.” [Aal Imran: 18].

Kuptimi i Shehadetit është: nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. “Nuk ka të adhuruar me të drejtë”, kjo mohon çdo gjë që adhurohet përpos Allahut, ndërsa

“përveç Allahut”, kjo ia pohon adhurimin Allahut të vetëm, i Cili është i pashok (dhe s’ka të barabartë me Të) në adhurim, ashtu sikurse nuk ka shok (apo të barabartë) në sundim.

Komentimi dhe sqarimi për këtë që thamë, është thënia e të Lartësuarit:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ (26) إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ (27)
وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ

“Kujto kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: vërtetë unë jam i distancuar dhe urrej ato që ju adhuroni (përveç Allahut), i Cili më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë. Ai (Ibrahimi) e bëri këtë fjalë (shehadetin) të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen (tek kjo fjalë).” [ez-Zukhruf: 26-28].

Gjithashtu argument është edhe thënia e të Lartësuarit:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَإِن تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ

“Thuaj: o ithtarë të Librit! Ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se nuk do të adhurojmë vetëm se Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë

Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do të marrim të adhuruar njëri-tjetrin, në vend të Allahut! Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut.” [Aal Imran: 64].

Argument i dëshmisë se “Muhamedi është i Dërguari i Allahut”, është thënia e të Lartësuarit:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُوفٌ رَّحِيمٌ

“Pasha Allahun, ju ka ardhur një i Dërguar nga mesi juaj. Atë e mundon ajo që ju rëndon juve, ai përkujdeset për ju, dhe është i butë dhe i mëshirshëm me besimtarët.” [et-Teubeh: 128].

Kuptimi i dëshmisë se “Muhamedi është i Dërguari i Allahut”, është: bindja në atë që urdhëron, besimi për çfarë lajmëron, largimi nga ajo që ka ndaluar dhe qortuar, dhe të mos adhurohet Allahu vetëm se me atë që ka ligjëruar.

Argument për namazin, zekatin dhe komentimin e teuhidit, është thënia e të Lartësuarit:

وَمَا أُمْرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقِيَمَةِ

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të veçonin me adhurim Allahun, me përkushtim të sinqertë, duke u larguar nga shirku dhe drejtuar nga teuhidi, si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.” [el Bejjineh: 5].

Argument për agjërimin është thënia e të Lartësuarit:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“O ju të cilët keni besuar! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu si i ishte bërë obligim atyre para jush, që të mund të zbatoni urdhëresat dhe largoheni nga ndalesat.” [el Bekare: 183].

Argument për haxhin është thënia e të Lartësuarit:

وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ

“Dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush mohon, Allahu nuk ka nevojë për askënd.” [Aal Imran: 97].

Grada e dytë

Imani: i cili përbëhet prej shtatëdhjetë e ca pjesësh: më e larta është thënia “*La ilahe il-lAllah*”, ndërsa më e vogla është largimi i një pengese nga rruga, edhe turpi është pjesë e Imanit (e besimit).

Shtyllat e Imanit janë gjashtë, sikurse në hadith:

أَنْ تُوْمَنَ بِاللَّهِ، وَمَلَائِكَتِهِ، وَكُتُبِهِ، وَرَسُولِهِ، وَالْيَوْمِ الْآخِرِ، وَبِالْقَدْرِ خَيْرِهِ شَرَهُ

“Të besosh Allahun, melaiket e Tij, Librat e Tij, pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe Kaderin (caktimin) i mirë apo i keq qoftë”. Argument për këto gjashtë shtylla, është thënia e të Lartësuarit:

لَيْسَ الْبِرُّ أَنْ تُوَلُّوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ
وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi (pa urdhër prej Allahut), por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Gjykimit, melaiket, Librat dhe pejgamberët.” [el Bekare: 177].

Argument për Kaderin (caktimin) është thënia e të Lartësuarit:

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ

“Vërtetë Ne e kemi krijuar çdo gjë me caktim.” [el Kamer: 49].

Grada e tretë

Ihsani ka një shtyllë, sikurse thuhet në hadith:

أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ، فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ

“Ta veçosh Allahun me adhurim sikur je duke e parë, edhe përse ti nuk e sheh Atë, vërtetë Ai të shikon ty.”

Gjithashtu argument është edhe thënia e të Lartësuarit:

إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ

“Vërtetë Allahu është me ata që zbatonjë urdhëresat dhe largohen nga ndalesat, dhe që janë punëmirë.” [en-Nahl:128].

وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ (217) الَّذِي يَرَاكَ حِينَ تَقُومُ (218) وَتَقَلُّبِكَ فِي السَّاجِدِينَ
(219) إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

“Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përgjenden në sexhde. Vërtet Ai është Dëgjuesi dhe i Gjithëdituri.” [esh-Shuara’: 217-220].

وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُو مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ

“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune (të madhe apo të vogël) që të bëni, Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të.” [Junus: 61].

Ndërsa argument nga Suneti është “hadithi i Xhibrilit” i mirënjohur prej Umer ibnil Khatab *radijAllahu anhu* se ka thënë:

“Gjersa ishim të ulur tek Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, na u shfaq një burrë me rroba shumë të bardha, me flokë shumë të zeza, nuk vërehej tek ai shenja udhëtimi dhe as që e njihte ndonjëri prej nesh. Ai u ul tek

Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* duke ngjeshur gjunjët e tij tek gjunjët e Pejgamberit, dhe duke vendosur duart e tij mbi kofshët e Pejgamberit, e pastaj tha: o Muhamed! Më trego se çfarë është Islami?

Ai u përgjigj:

أن تشهد أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسول الله، وتقيم الصلاة وتؤتي الزكاة، وتصوم رمضان،
وتحج البيت إن استطعت إليه سبيلاً

“Të dëshmosh se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të vizitosh Qaben (të bësh haxhin) nëse ke mundësi.”

Ai tha: të vërtetën ke thënë. Kurse ne u habitëm, ai edhe po pyet, edhe po e miraton. Më pas tha: më trego se çfarë është Imani?

Pejgamberi u përgjigj:

أن تؤمن بالله، وملائكته، وكتبه، ورسوله، واليوم الآخر، وبالقدر خيره شره

“Të besosh Allahun, melaiket e Tij, Librat e Tij, pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe Kaderin (caktimin) i mirë apo i keq qoftë.”

Ai tha: më trego se çfarë është Ihsani?

Pejgamberi u përgjigj:

أن تعبد الله كأنك تراه، فإن لم تكن تراه فإنه يراك

“Ta veçosh Allahun me adhurim sikur je duke e parë, edhe përse ti nuk e sheh Atë, vërtetë Ai të shikon ty.”

Ai tha: më trego rreth Kiametit?

Pejgamberi u përgjigj:

ما المسؤول عنها بأعلم من السائل

“I pyeturi nuk ka më shumë njohuri sesa pyetësi.”

Ai tha: më trego rreth shenjave të tij?

Pejgamberi u përgjigj:

أن تلد الأمة ربتها، وأن ترى الحفاة العراة العالة رعاء الشاء يتطاولون في البنيان

“Kur të lindë robëresha zonjën e saj, dhe të shikosh barinj të këmbëzbathur, fukarenj dhe të varfër që garojnë në ngritjen e ndërtesave.”

Tha (Umeri): ai iku, kurse ne qëndruam një copë here, e pastaj Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* tha:

يا عمر أتدري من السائل؟

“O Umer! A e di se kush ishte pyetësi?”

Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë, dhe ai tha:

هذا جبريل أتاكم يعلمكم أمر دينكم

“Ky ishte Xhibrili, erdhi t’ju mësojë çështjet e fesë suaj.”

🕌 Parimi i tretë 🕌

Njohja e Pejgamberit tuaj Muhamed *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*. Ai është Muhamedi i biri Abdullahut i biri i Abdulmutalibit i biri i Hashimit, Hashimi ka qenë prej Kurejshëve, Kurejshët kanë qenë prej arabëve, dhe arabët janë prej pasardhësve të Ismailit, birit të Ibrahimit, që Allahu e donte me një dashuri të madhe. Mbi Ibrahimin dhe mbi Pejgamberin tonë qofshin shpëtimi dhe lavdërimet më të mira prej Allahut. Ai ka jetuar gjashtëdhjetë e tre vite, ku dyzet prej tyre i ka kaluar përpara pejgamberisë, ndërsa njëzet e tre i ka kaluar si Pejgamber dhe i Dërguar. Ai u bë Pejgamber me “Lexo”¹, dhe u bë i Dërguar me “I mbuluar”².

Vendlindja e tij është Meka, dhe më pas ka emigruar (ka bërë hixhret) për në Medine. Allahu e dërgoi atë që të paralajmëronte nga shirku dhe të thërriste drejt teuhidit.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ (1) قُمْ فَأَنْذِرْ (2) وَرَبِّكَ فَكَبِّرْ (3) وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ (4) وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ (5)
وَلَا تَمَنَّيَنَّ تَسْتَكْبِرُ (6) وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ

¹ Me ajetet e para të sures Alak. [shp].

² Me ajetet e para të sures el Mudethir. [shp].

“O ti i mbuluar! Ngrihu dhe paralajmëro. Kurse Zotin tënd madhëroje. Rrobat e tua pastroji, dhe largohu nga adhurimi i idhujve. Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë, dhe për hir të Zotit tënd, duro.”
[el Mudethir: 1-7].

Kuptimi i **“Ngrihu dhe paralajmëro”**, të paralajmërojë nga shirku, dhe të thërrasë drejt teuhidit. **“Kurse Zotin tënd madhëroje”**, dmth madhëroje me teuhid (duke e veçuar Allahun me adhurim). **“Rrobat e tua pastroji”**, dmth pastroji veprat e tua nga shirku. **“dhe largohu nga adhurimi i idhujve”**, të larguarit nga idhujt bëhet duke i braktisur dhe duke hequr dorë nga ato dhe përkrahësit e tyre.

Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, kaloi dhjetë vjet duke thirrur për në teuhid, e më pas ai u ngrit në qiell ku dhe iu bë obligim falja e pesë namazeve. Ai u fal në Mekë për tre vjet, e më pas u urdhërua për emigrim (hixhret) drejt Medines. Hixhret është: të shpërgulurit nga një vend shirku, drejt një vendi musliman.

Të bërit hixhret nga një vend mosbesimi drejt një vendi musliman, është obligim për këtë ymet, dhe kjo dispozitë do të vazhdojë të jetë në fuqi derisa të bëhet Kiameti.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

إِنَّ الَّذِينَ تَوَقَّاهُمْ الْمَلَائِكَةُ ظَالِمِي أَنْفُسِهِمْ قَالُوا فِيهِمْ كُنْتُمْ قَالُوا كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ فِي الْأَرْضِ
قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضُ اللَّهِ وَاسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا فَأُولَئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمَ وَسَاءَتْ مَصِيرًا (97) إِلَّا
الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا (98)
فَأُولَئِكَ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَعْفُوَ عَنْهُمْ وَكَانَ اللَّهُ عَفُورًا

“Kur melaiket ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me gjynahe, u thonë: “Në ç’gjendje ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në tokë”. (Melaiket) do t’u thonë: “A nuk qe toka e Allahut e gjerë që të emigronit në të?” Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa përfundim i keq është ai! Me përjashtim të burrave të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë. Mbase Allahu i fal, se Allahu me të vërtetë është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.” [en-Nisa’: 97-99].

Poashtu dhe thënia e të Lartësuarit:

يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَاسِعَةٌ فَإِيَّايَ فَاعْبُدُونِ

“O robërit e Mi të cilët keni besuar! Vërtetë Toka Ime është e gjerë, kështu që më veçoni Mua me adhurim.” [el Ankebut: 56].

Ka thënë Begauiu, Allahu e mëshiroftë: “Shkaku i zbritjes së këtij ajeti, kanë qënë muslimanët në Mekë të cilët nuk bënë hixhret; Allahu i thirri ata me emërtimin e besimit.”

Argument nga Suneti për hixhretin, është thënia e Pejgamberit *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

لا تنقطع الهجرة حتى تنقطع التوبة، ولا تنقطع التوبة حتى تطلع الشمس من مغربها

“(Dispozita) e hixhretit nuk do të ndërpritet pa u ndërprerë (dispozita) e pendimit, dhe (dispozita) e pendimit nuk do të ndërpritet, derisa Dielli të lindë nga perëndimi.”

Kur Pejgamberi u vendos në Medine, mori urdhëresat për dispozitat e tjera të Islamit, si: zekati, agjërimi, haxhi, ezani, xhihad, urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja dhe dispozita të tjera të Islamit. Ai vazhdoi të thërrasë në të lartpërmendurat edhe dhjetë vite të tjera, e më pas ndërroi jetë *salatUllahi ue selamuhu alejhi*, ndërsa feja e tij vazhdon. Kjo është feja e tij, nuk ka të mirë, vetëm se e ka drejtuar ymetin drejt saj, dhe nuk ka të keqe, vetëm se ka paralajmëruar prej saj. E mira drejt të cilës ka drejtuar, është: teuhidi bashkë me të gjitha gjërat që Allahu i do dhe kënaqet prej tyre. Kurse e keqja prej të

cilës ka paralajmëruar, është: shirku bashkë me gjitha gjërat që Allahu i urren dhe i refuzon.

Allahu e ka dërguar atë për të gjithë njerëzit, dhe e ka bërë obligim bindjen ndaj tij për të gjithë njerëzit dhe xhindët.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعاً

“Thuaj: o njerëz! Vërtetë unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.” [el Earaf: 158].

Me anë të tij, Allahu ka plotësuar fenë. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِيناً

“Sot plotësova për ju fenë tuaj, e përmbusha mirësinë Time mbi ju, dhe u kënaqa për ju me Islamin si fe.” [el Maideh:3].

Ndërsa argument për vdekjen e tij, është thënia e të Lartësuarit:

إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَيِّتُونَ (30) ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخْتَصِمُونَ

“Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë, dhe sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!” [ez-Zumer: 30-31].

Njerëzit pasi të vdesin do të ringjallen, dhe argument për këtë, është thënia e të Lartësuarit:

مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” [Taha: 55]. Gjithashtu (argument) është edhe thënia e të Lartësuarit:

وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِّنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا (17) ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا

“Allahu ju ka krijuar nga toka (ashtu si bimët), pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t’ju nxjerrë.” [Nuh: 17-18].

Pas ringjalljes, njerëzit merren në llogari, e më pas shpërblehen në bazë të veprave të tyre.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيُحْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا
بِالْحُسْنَى

“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t’i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta, dhe për t’i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.” [en-Nexhm:31].

Kushdo që e përgënjeshton ringjalljen, vetëm se ka bërë *kufër* (ka dalë nga Islami dhe është mosbesimtar).

Argument për këtë, është thënia e të Lartësuarit:

زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ وَذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ

“Mosbesimtarët kujtojnë se nuk do të ringjallen. Thuaju: “Po, pasha Zotin tim, me siguri që do të ringjallenit e pastaj do të njoftoheni për atë ç’ka keni bërë!” Dhe kjo është e lehtë për Allahun.” [et-Teghabun: 7].

Allahu i ka dërguar të gjithë pejgamberët si përgëzues dhe paralajmërues.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

“(Këta janë) të dërguar që janë përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim para Allahut, pas ardhjes së të dërguarve.” [en-Nisa’: 165].

I dërguari i parë ka qënë Nuhu *alejhis-selam*, ndërsa i fundit Muhamedi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* i cili është Vula e pejgamberëve.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ

“Ne të zbritëm ty (o Muhamed) shpallje, ashtu siç i zbritëm shpallje Nuhut dhe profetëve pas tij.” [en-Nisa’: 163].

Allahu ka dërguar tek çdo popull të dërguar, që nga Nuhu deri tek Muhamedi, dhe i ka urdhëruar për adhurimin e Allahut të vetëm, dhe i ka ndaluar nga adhurimi i *taghutit*.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ

“Pasha Allahun, Ne dërguam tek çdo popull të dërguar, që t’i thonin (popujve të tyre): adhuroni vetëm Allahun, dhe largohuni nga *taghuti* (çdo gjë që adhurohet përpos Allahut).” [en-Nahl: 36].

Allahu i ka vënë detyrë të gjithë njerëzve, që ata të mohojnë *taghutin*, dhe të besojnë Allahun.

Ka thënë Ibnul Kajimi (Allahu e mëshiroftë):
“Kuptimi i *taghut*-it është: kur njeriu e tejkalon kufirin në atë që adhuron, e pason, apo i bindet.”

Taghut-ët janë të shumtë, mirëpo kryesorët e tyre janë pesë: Iblisi (Allahu e mallkoftë), personi që adhurohet dhe është i kënaqur me adhurimin që i bëhet, kush thërret drejt adhurimit të tij, kush pretendon diçka prej dijes së fshehtë, dhe ai që gjykon me ligj tjetër veç asaj që ka zbritur Allahu.

Argument për këtë, është thënia e të Lartësuarit:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنِ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ
بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon *taghut*-in (gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, vetëm se është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu është Dëgjuesi dhe i Gjithëdituri.” [el Bekare: 256]. Dhe ky është kuptimi i fjalës *La ilahe il-lAllah*.

Ndërsa në hadith thuhet:

رَأْسُ الْأَمْرِ الْإِسْلَامُ، وَعَمُودُهُ الصَّلَاةُ، وَذِرْوَةٌ سَنَامِهِ الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ

“Çështja kapitale është Islami, namazi është shtylla e tij, kurse pika kulminante është xihadi në rrugë të Allahut.”

Allahu është më i Dituri, lavdërimet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Përktheu: Besmir Cacani

